



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

Procesverbal

I mbajtur sot në datë 28.02.2022 në mledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër.

Mbledhja po zhvillohet në mjediset e Këshillit të Qarkut. Marrin pjesë në mbledhje 16 anëtarë të K.B.Vjen në mbledhje Arben Rexhaj.Mungojnë në mbledhje; Merita Isaraj, Zamira Veizi,Eduina Guga, Armand Feruni, Armand Hilaj, Argjiro Muho, Valentina Balloma, Manjola Shehaj, Karolina Xheko, Grusilda Çamani, Dashamir Qeli.

Hapet mbledhja nga Z. Hasani. Lexohet rend i ditës.

1. Miratim i proceverbalit të mbledhjeve të datës 31.01.2022 dhe 18.02.2022 .
2. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-28.02. 2022**”.
3. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-28.02. 2022**”.
4. P/Vendim “ Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Gjirokastër të pronës së paluajtshme shtetërore e cila do të përdoret në fushën e zhvillimit ekonomik dhe bujqësor”
5. P/Vendim “Për miratimin e shpërndarjes të së trashëguarës në buxhetin e vitit 2022”.
6. P/Vendim “Raporti mbi vlerësimin afatmesëm të të ardhurave 20223-2025”.
7. P/Vedim për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për individë /familjeqë nuk përballojnë qiranë e tregut të lirë.Vlera e buxhetit të shtetit 143.lekë/muaj dhe 128.000lekë/muaj bashkia Gjirokastër.
8. P/Vendim “Mbi miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme sot (ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit.”
9. P/Vendim “Për vendosjen e z. Ramo Koro në shtëpinë e të moshuarve “Shpresa e Jetës”Gjirokastër”.
10. P/ Vendim “Për vendosjen e emërtimit të rrugëve”.
11. Raporti vjetor i punës së Drejtorisë së Ujësjetës.
12. Raporti vjetor i punës së Këshillit Bashkiak për vitin 2021

Kërkohet nga znj. Albana Alushaj përfshirja një projekt aktit, pwr “ Miratimin e vlerws sw grantit tw menjwhershwm pwr banesat me kosto tw ulwt nga Buxheti i Shtetit pwr Z. Fatmir Gega me vlerwn 73.600 lekwn” si dhe miratimi i kërkesës për siistemimin e 5 të moshuarve në shtëpinë e të moshuarve “Shpresa e Jetës”.

Pyetje nga Petrit Brahimi: Pse nuk është sjellë në kohë dhe pse për një person miratohet dhe për tjetrin jo? E njëjta pyetje edhe nga Z. Gentian Llogo. Sqarohen nga z. Nebiaj kategoritë që parashikon Ligji, arsyet e tejkalimit të afateve dhe kriteret e skualifikimit

Z. Arben Rexhaj. Ne jemi dakord për çdo mbështetje për shtresat në nevojë

Miratohet me 17 vota pro dhe një votë kundër rendi i ditës me pikën shtesë për: Miratimin e vlerës së grantit të menjshëm për banesat me kosto të ulët nga Buxheti i Shtetit për Z. Fatmir Gega me vlerën 73.600 lekë si dhe miratimi i kërkesës për sistemin e 5 të moshuarve në shtëpinë e të moshuarve "Shpresa e Jetës".

Miratohet pika shtesë me 17 vota pro dhe një votë kundër.

Miratohet për të futur në rendin e ditës përfshirja e 4 të moshuarve të tjerë për t'u sistemuar në Shtëpinë e të Moshuarve "Shpresa e Jetës".

Miratohen procesverbalet e mbledhjes së datës 31.01.2022 dhe të mbledhjes së datës 18.02.2022. Kalohet te pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës. **Miratohen me 18 vota pro**: P/Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-28.02. 2022**".

P/Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-28.02. 2022**".

Pika 4 e rendit të ditës:

P/Vendim "Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë të pronës së paluajtshme shtetërore e cila do të përdoret në fushën e zhvillimit ekonomik dhe bujqësor"

Sqaron; Z. Nertil Nebiaj. Pasi miratohet nga Këshilli Bashkiak vazhdon procedura për ta certifikuar si pronë të Bashkisë. Është në inventarin e pronave të bashkisë, por nuk është e certifikuar.

Miratohet me 18 vota pro pika 4: "Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë të pronës së paluajtshme shtetërore e cila do të përdoret në fushën e zhvillimit ekonomik dhe bujqësor"

Z. Hasani: Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës. P/Vendim "Për miratimin e shpërndarjes të së trashëguarës në buxhetin e vitit 2022".

Znj. Rova: Komisioni e ka parë materialin dhe e ka kaluar.

Jepen sqarimet nga Znj. Artiste Koko në lidhje me miratimin e shpërndarjes së të trashëguarës.

Kontrat janë të nënshkruara për datë 31.12.2021, por veprimet mbylleen në 25, 26 dhjetor, prandaj mbeten të përpunuara dhe vazhdon realizimi i tyre në vitin pasardhës. Tepërcat rishpërndahen sipas drejtorive, sepse ka të bëjë me karburantet, gjyqësorin, internetin, shpenzimet administrative etj.

Z. Karagiozi. Është rutinë ky proces, ndodh në çdo institucion shpërndarja e të trashëguarës.

Miratohet me 18 vota pro. P/Vendim "Për miratimin e shpërndarjes të së trashëguarës në buxhetin e vitit 2022".

Pika 6 e rendit të ditës.

Ka diskutime për materialin i cili nuk ka firmat e specialistëve, por sqarohet që materiali është me firmat e duhura fizikisht, por është printuar nga emaili.

Miratohet me 12 vota pro kalimi i kësaj pike për diskutim .

Sqaron materialin në emër të Drejtorisë së të Ardhurave Bledar Lapaj. Bashkia Gjirokastrë administron të ardhura që vijnë nga taksat locale, tarifat vendore, dhe nga taksat e ndara me pushtetin qendror. Për vitet 2023-2025 është parashikuar një rritje e lehtë e të ardhurave. Ky raport paraqet një planifikim të pritshëm dhe sa më afër realitetit.

Znj: Rova : Të shpresojmë në realizimin e tyre edhe pse rritjet janë të lehta.

Z. Karagjozi: PBA është orientues, kurse buxheti 2022 është i bazuar në statistika reale, të dhëna reale. Në këto parametra ky planifikim është me këmbë në tokë . Patjetër që do të ketë edhe ndryshime që ndodhin Brenda vitit.

Z. Petrit Brahimi: Të kishim një material mbi realizimin e vitit paraardhës. Çdo 4 muaj këshillit duhet t' i paraqitet një raport për të ardhurat dhe shpenzimet, realizime, mosrealizime.

Pyetje: Z. Naçi: Janë rritur disa taksa? Shoh disa taksa që janë trefishuar.

Znj. Rova: I kemi kaluar ne, janë miratuar nga Këshilli tarifat.

Miratohet me 18 vota pro “P/Vendim“Raporti mbi vlerësimin afatmesëm të të ardhurave 20223-2025”. Z. Hasani: Kalojmë te pika 7 . P/Vendim për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për individë /familje që nuk përballojnë qiranë e tregut të lirë. Vlera e buxhetit të shtetit 143. lekë/muaj dhe 128.000lekë/muaj Bashkia Gjirokastrë”

Znj: Rova: Pse nga 23 familje/individë janë miratuar 20?

Znj; Allushaj ; nuk kanë sjellë dokumentacionin të rregullt dhe kur të plot dok kalojnë përseri me vendim Këshilli.

Miratohet me 16 vota pro P/Vendim për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për individë /familje që nuk përballojnë qiranë e tregut të lirë. Vlera e buxhetit të shtetit 143. lekë/muaj dhe 128.000lekë/muaj Bashkia Gjirokastrë.

Miratohet me 17 vota pro P/Vendim “Mbi miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajshme sot (ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit.”

Pika 9 e rendit të ditës. Në Sekretariat është paraqitur vetëm një kërkesë për sistemimin në shtëpinë e të moshuarve Brenda afatit, por pranë drejtorisë janë drejtuar edhe 4 kërkesa të tjera.

1. Ramo Koro.
2. Hajredin Llace
3. Dushan Gjini
4. Majlinda Gaço (sistemim i përkohshëm).
5. Feti Haxhiu

Miratohet me 18 vota p/Vendimi për “Akomodimin e 5 individëve në Shtëpinë e të Moshuarve “ Shpresa e Jetës”, Gjirokastrë”.

Z. Brahimi: Falënderojmë Drejtorinë e Shërbimeve Sociale për hulumtimin e rasteve që kanë nevojë për ndihmë.

Z. Hasani: Kalojmë te pika 10. P/ Vendim "Për vendosjen e emërimit të rrugëve".

Z. Brahimi: Në respect të emrave që janë sjellë dhe veprës së tyre, si dhe faktit që kanë marrë titullin "Dëshmor i Atdheut" jam plotësisht dakord.

Znj. Florika Qafzezi; Doja të dija sa kërkesa ka?Kujtoj shumë kërkesa në lidhje me familjarët e Xhevat Avdallit, Miho Kristos, sepse ka emra rrugësh që nuk I njeh njeri.

Z. Brahimi: Për këtë rast vota ime është pro, por nuk duht tw lejojmë emra rrugësh për njerëz që nuk i njeh askush.

E kemi kërkuar një rishikim të emrave të rrugëve para një viti e gjysmë. Në mbledhjen më të afërt duhet të merremi me këtë gjë.

Z. Naçi: Jam dakord me parafolësit.Të respektohet radha., të gjendet zgjidhja për Xhevat Avdallin.

Z. Shpëtim Guçe: Mendoj se problem është te mosfunktionimi real i Komisionit të Këshillit Bashkiak.

Duhet një bashkëpunim me Urbanistikën. Nuk ka rrugë te lagjja e tij, nuk mund të vendoset emri ne lagjen " Zinxhira". Janë bërë titujt e nderit si kartona pa vlerë.Duhen kriteret bazë për të qenë një emër.

Z. Hasani: Nuk janë zbatuar vendimet e mëparëshme. Vendimi është për një studim të përgjithshëm.

Z.Rova; Të rishikohet dhe nuk ka ardhur ende në Këshill.

Z.Karagjozi:Të gjitha konvergohen në një pikë, rishikim i plotë i emrave.

Z.Brahimi; Në fund të muajit prill Këshilli Bashkiak, Kryetarja e Këshillit të Qarkut, Kryetari i Këshillit Bashkiak të diskutojnë dhe të vijnë me një konkluzion për zgjidhjen e këtij ngërçi.

Z.Kaci: Grup i punës është i zgjeruar. Kërkesat vijnë nga institucionet, target grupe etj.

Z.Rova:Grup i punës i zgjeruar eshte një diskutim i gjërë.duhet të jetë grup pune mbi institucionet.

T'i përcillet kërkesa për një komision të gjërë Kryetarit të Bashkisë.

Z.Brahimi;Kryesia e Këshillit të Bashkiak t'i japi një zgjidhje problemit.

Miratohet vendimi me 17 vota pro "Për miratimin e vendosjes së emrave të rrugëve. Raporti i Drejtorisë së Ujësellsit.

Z.Karagjozi: Si funksionon investimi i madh që po bëhet te ujësjellësi?

Z.Llogo: Gjithë veprimtaria hartohet nga Banka Gjermane dhe AKUMI.

Z.Rova; Jo tolarante për raportimet dhe llogaridhënien e aparatit.aparateve.

Z.Brahimi: Nuk na duhet përfaqësues nga Bashkia, është pronë e K.B, analiza e KB është këto dy çështje i takojnë K.B.

Vërejtje edhe me mbledhje

Z.Qafzezi;

Z.Brahimi ;Pyetje rreth materialeve.

Si del ndërrmarja ? Të ardhurat dhe shpenzimet ?

Z.Karagjozi: A keni një planifikim, sa do të mblidhni të ardhura, sa merren konkretisht?.

Z.Llogo: 3 pika , faturimi , arkëtimi, shpenzimet. Ua sqaroj të ardhurat shpenzimet 111 lekë të ardhura ,105 ml lekë shpenzime.

Largimi nga zona rurale. Mosdhënia e shërbimi. Parashikimi me ulje ngritje. Buxheti është ky që ju është paraqitur. Ndërmarrja del me fitim por të mos harrojmë problematikat që ka me rezidentët dhe jorezidentet.

Z.Karagozi; Sa më mirë do ishte

Z.Llogo; Ju sjell buxhetin e ujwsjellwsit, çfarë është bërë gjatw vitit 2021.

Z.Hasani; Në raport shikojmë rritje në qytet, kemi rënie në njësitë administrative , abonentet janë rritur. Pse nuk është me e madhe rritja?

Z.Llogo;Fshatrat janë ndryshe rezidentët nga, jo rezidentet tarifohen ndryshe.Ka largime masive nga fshatrat.

Z. Hasani :Çfarë plani masash ka për abonentët qe nuk kanë paguar?

Z.Llogo: Difektet janë raportuar .Kemi ankesa që janë më ulje nga viti në vit.

Z.Qafëzezi: Janë vënë matësa të rinj. Është vënë në punë ujësjellësi i ri në qytet?

Z.Llogo ; Nuk.. maten . Nga investimi i ri është me provë Kodra e Shtufit.

Z.Brahimi: Rruget janë betonuar keq nga firma që ka punuar. Këto janë kostot për Bashkinë, rikthimi në identitet i rrugëve. Duhet të bëni verifikimin e kryerjes së rehabilitimit si kanë qenë para se të merret në dorëzim.

Mbyllet mbledhja nga Z. Hasani.



The first part of the document is a letterhead from the Ministry of Education and Science of the Republic of Kazakhstan. It includes the name of the ministry and the name of the specific department or office. The text is in Russian and is partially obscured by a large watermark.

The second part of the document is a list of names and titles, likely representing a committee or a group of officials. The names are listed in Russian and include titles such as "Minister" and "Deputy Minister".

The third part of the document is a list of names and titles, likely representing a group of officials or a committee. The names are listed in Russian and include titles such as "Minister" and "Deputy Minister".

The fourth part of the document is a list of names and titles, likely representing a group of officials or a committee. The names are listed in Russian and include titles such as "Minister" and "Deputy Minister".

